



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 138/₄ Prot.

Tiranë, më 1/8/2013

Lënda: Rekomandim për Agjenci Imobiliare "Century 21" Tiranë

REKOMANDIM

Nr. 14, datë 01/08/2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit ,

KONSTATOVA

Nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit farmaci "Agimi", Tiranë me objekt:

- Ligjshmëria e mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale për kategorinë "klientë", sipas ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Nga kontrollit administrativ u konstatua se:

Kontrolluesi Agjenci Imobiliare "Century 21" operon me shit-blerjeve-qera te pasurive te paluajtshme në tregun imobiliar. Këto shërbime i kryen me anë të kontratave të ndërmjetësimi: me klientët e saj. Në pikën II të kontratës së lidhur me klientin ka të parashikuar shprehimisht: *"Agjencia do të trajtojë të gjithë informacionin e marrë nga klienti në mënyrë konfidenciale në përputhje me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, dhe nuk do të kryej asnjë veprim i cili mund të çënojë interesat e klientit"*.

Përfaqësuesja deklaroi se dokumentat e klientëve të saj i mban elektronikisht ose edhe në mënyrë manuale sipas rastit, gjithashtu u shpreh se nuk ka një rregullore të brendshme ku te jetë parashikuar mënyra e mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale për kategorinë "klientë".

Gjatë ofrimit të shërbimeve ndaj klientëve Agjencia Imobiljare "Century 21" mbledh informacion dhe dokumenta të nevojshme për përbushjen e detyrimeve të Agjencisë sipas kontratës. Agjencia në fushën e veprimtarisë së saj liston, reklamon publikisht të dhëna në lidhje me pronën e klientit, në çdo media informative duke përfshirë web-site, apo media të tjera elektronike.

Në kontratën e ndërmjetësimit me klientin agjencia e ka të parashikuar në pikën 2.5 të kontratës sa më sipër. Por në lidhje me pëlqimin e shprehur të klientit dhe informimin e tij për qëllimin e përpunimit të të dhënave në lidhje me përhapjen e të dhënave personale në palë të treta për përmbushjen e qëllimit për të cilin është lidhur kontrata, kontrolluesi agjencia "Century 21" duhet të ketë një mënyrë të qartë dhe të shprehur për subjektet e të dhënave personale 'klientë' në lidhje me detyrimin për informim gjë e cila duhet të përfshihet në mënyrë të shprehur në një formular bashkëlidhur kontratës së ndërmjetësimit në përputhje me kriteret e nenit 18 pika 1) si dhe nenit 6 pika 1a) të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" ku citohet shprehimisht se:

" kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do të përpunohet të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij".

" Të dhënat personale përpunohen vetëm: a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin".

U konstatua gjithashtu se kontrolluesi Agjenci Imobiliare "Century 21" deri në momentin e dorëzimit të proces-verbalit nuk e kishte kryer detyrimin ligjor për të njoftuar pranë Komisionerit.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi pretendimet e kontrolluesit si dhe provat e administruara vëren se:

- Kontrolluesi Agjenci Imobiliare "Century 21" nuk ka një rregullore të shkruar për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të klientëve në zbatim të nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 " Per mbrojtjen e të dhënave personale" .
- Nuk merret pëlqimi i shprehur nga klientët në lidhje me mbledhjen, regjistrimin, përhapjen, përpunimin e të dhënave të tyre personale nëpërmjet një formulari të veçantë fizik në zbatim të nenit 6 pika 1 gërma "a" të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
- Kontrolluesi nuk ka ndonjë dokument të qartë (formular të veçant fizik) ku të jetë shprehur për qëllimin e përpunimit, mbledhjes të të dhënave personale të klientëve në përputhje dhe në zbatim të nenit 18 pika 1) të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
- Nga kontrolli administrativ i ushtruar rezulton se kontrolluesi Agjenci Imobiliare "Century 21" nuk e ka plotësuar detyrimin për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në këto kushte vlerësoj se është shkelur:

- **Neni 27 pika 2/1 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

“Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat teknik-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale , në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera”

- **Neni 28 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

“Kontrolluesi, përpunuesi dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara në ligj...”

- **Neni 6 pika 1a) i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

“ Të dhënat personale përpunohen vetëm: a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin”.

- **Neni 18 pika 1) të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”**

“kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin,.....”.

- **Neni 21 pika 1 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

“Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës....”.

Për sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

- 1- Në zbatim të nenit 21 i Ligjit Nr. 9887 datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të përmbushi detyrimin ligjor për plotësimin e Formularit të njoftimit brenda 2 (dy) ditëve punë kalendarike.
- 2- Të informohet dhe të merret pëlqimi në mënyrë të shprehur i klienti në lidhje me mbledhjen, regjistrimin, përhapjen, përpunimin e të dhënave të tyre personale nëpërmjet një formulari të veçantë fizik në zbatim të nenit 6 pika 1 gërma “a”, si dhe nenit 18 pika 1) të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- 3- Në zbatim të nenit 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të merren masa për hartimin e një rregullore të shkruar për

mbledhjen, mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen, kofidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave personale.

- 4- Detyrimet e rëndësishme të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij Rekomandimi, të realizohen brenda një afati kohor prej 45 (dyzetëepesë) ditësh;
- 5- Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- 6- Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", sipas të cilit "*Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave*".

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

